



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 04 prot.

Himarë, më 03.03.2025

PROCESVERBAL

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË RADHËS PËR MUAJIN SHKURT TË KËSHILLIT BASHKIAK HIMARË ZBARDHUR NGA ORGJINALI, I MBAJTUR SOT MË DATË 03.03.2025, ORA 10:30, NË SALLËN “ NEÇO MUKO “ HIMARË.

Sot më datë 03.03.2025 zhvillohet mbledhja e radhës të Këshillit Bashkiak Himarë për muajin shkurt, e shtyrë nga data e njoftuar zyrtarisht e cila ishte vendos nga kryesia më datë 28.02.2025. Të ftuar; kryetari Bashkisë, administratorët e njësive, drejtoritë, kryetarët e fshatrave.

Marrin pjesë këshilltarët:

1. Dhimitër Kapaj, 2. Lenica Kocani, 3. Timoleo Gërdhuqi, 4. Afrovita Dhimojani, 5. Loreta Isufi, 6. Artan Bala, 7. Mirka Gjiçali, 8. Elisabeta Lamaj, 9. Fuat Mati, 10. Qirjako Mërkuri, 11. Milto Nika, 12. Aleks Llazari, 13. Nikolin Laska, 14. Nertila Husi.

Mungojnë pa arsye: 1. Miltiadh Prifti, 2. Thëllëza Kokaveshi, 3. Silva Burbo (me arsye) 4. Gjergji Iliadhi, 5. Artionil Shirokaj, 6. Thodhori Foto, 7. Maks Vlasho.

Plotësohet Kuorumi këshilltarëve .

Komunikohet këshillit shprehja e ligjshmërisë së vendimeve të mbledhjes së kaluar .

Hap mbledhjen kryetari këshillit .

Pika 1. Për miratimin e listës të kullotave e kositje për sezonin kullosor veror dhe dimërore për vitin 2025 si dhe kontrata TIP .

Sqaron Kryetari Bashkisë : - Kullotat jepen me kontratë nga Bashkia sipas kërkesave .

Kryetari Këshillit :- Për korrjen e sherebelit si kontaktohet? Kryetari Bashkisë :- Kam parë vetë që korret sherebel dhe kam kontaktuar me komisariatit të monitorohet kjo çështje.

Z. Milto Nika: I plotëson të gjitha nevojat bashkia jonë? Kapacitet për kullotë janë të plotësuara, vende bosh kemi , thekson drejtori përkatës dhe kontrata që ju kam sjell në bazë të VKM është kontrat dhe duhet ti plotësojmë , kurse analizë është tjetër gjë.

Z.Timoleo Gërdhuqi: A ka shtesë që mund të prish ndonjë zonë? Mund të ketë vetëm për kullotje? Jo :- drejtori.

Kryetari Këshillit :- Juve i plotësoni kriteret vetëm për banorët e Himarës , udhëzimi vijon për kullotat me qëra dhe kriteret janë të afishuara , kam dijeni që nuk janë pajisur blegtor me kullotë, nëse keni zona të lira pse nuk i jepni kontratat .

Drejtori Ilirjan Gjika : - Nuk kam djeni për këtë .

Z.Fuat Mati :- Si funksionon? Kemi nxjerrë urdhër që kontratën e shfrytëzon vetëm ai që e merr.

Znj. Elisabeta Lamaj:- Kullota dimërore bosh ka në Himarë? Drejtori :- po.

Znj.Afrovita Dhimojani :- sa janë parcelat që disponohen dhe sa janë kërkesat ? **Drejtori:-** Nuk e kam këtë informacion tani , nëse doni jua sjellë në mbledhjen tjetër . Ne kemi pajisur çdo vendas me kullotë e pastaj edhe ata që shtegëtojnë.

Z.Milto Nika :- Keni shkatërruar dy nga gjërat më kryesore që janë blegtoria dhe bujqësia sot kullotat janë gjysmë për gjysmë, Lukovë është më e organizuar , dy njësitë e tjera nuk e kanë .Duhet një verifikim për këtë çështje sepse bëhen manipulime , kullotat shiten, ju lutem vëmëndje blegtorale, mallit të imtë sepse janë në rënie.

Z.Timoleo Gërdhuqi:- Jam ndesh me këtë problem dhe nuk shoh korrupsion në dëgjesat publike kam propozuar për standardet në njësinë Horë – Vranisht, Himara është për të gjithë , le të vijmë në bazë të kërkesave dhe të miratohen.

Kryetari Këshillit :- E hedhim në votim?

Miratohet vendimi nr.09 me 14 vota pro , zero kundër, zero abstenim për miratimin e listës së kullotave dhe kositje të gatshme si dhe kontrata tip për sezonin dimëror dhe vetor për vitin 2025.

Kryetari këshillit propozon të ndryshoj rendin e ditës dhe të shtohet një material tjetër i cili këshilli është njohur dhe e ka shqyrtuar në mbledhjet e mëparshme, në komision ka kaluar, e kemi shtyrë për mungesë të hartës derisa materiali të vinte i plotë. Sot materiali është i plotë nëse jeni dakort të futet në rend dite? Po- këshilli.

Znj. Lenica Kocani :- Kryetar ka ardhur një ankesë nga Kryetari i fshatit Ilias për këtë, të lutem lexoje! Kryetari Këshillit lexon ankesën,

Z.Timoleo Gërdhuqi :- Materiali ka ardhur i plotë dhe i studiuar, vazhdojnë diskutimet në këshillë.

Z.Qirjako Mërkuri :- Ne nuk jemi specialist për këtë, specialistët e kanë formuluar dhe e kanë sjellë.

Z.Fuat Mati :- Ne nuk japim pronë, japim për inerte, është sipërfaqe që ja japim të detajuar dhe le ta shfrytëzojnë.

Z.Aleks Llazari :- Nuk është e detajuar si material.

Sqaron Kryetari Bashkisë:-Kërkuar studim më të detajuar dhe mbasi e keni verifikuar j'ua kemi sjellë, kemi hequr gjithë pjesën e AMTP – ve në atë zonë . Janë dhënë leje në rrugët nacionale më përpara dhe banorët janë ankuar dhe unë kam firmos urdhër të ndalojë kjo gjë.Për të njëjtën çështje ngrihet edhe Ilias dhe Dhërmi më bën përshtypje sepse jam kundër konkurrencës së pandershmërisë edhe nëse prek qytetarët një gjë jam kundra, unë jam me ju.Nëse është e vlefshme e miratoni. Kryetari fshatit Ilias nga Salla shprehet se ka sjell ankesë me emra dhe firma të bashkëfshatarëve për të mos e miratuar në këshillë , e lexon kryetari ankesën.

Kryetari këshillit :- kjo shkresë është e pabazuar në ligj dhe duket e firmosur nga një dorë e vetme duket e falsifikuar megjithatë ky material kalon në parim sot.

Kryetari fshatit Ilias:- ju lutem ta merrni në konsideratë ankesën!.

Kryetari këshillit :- E hedhim në votim ? Sa janë pro ? Kundra? Abstenim?

11 vota pro , 3 kundra (Lenica Kocani, Afrovita Dhimojani, Aleks Llazari)

Miratohet vendimi nr.10, për fillimin e bashkëpunimit me shoqërinë EGEU STONE , SH.P.K

Pika 2 e rendit të ditës e njoftuar zyrtarisht.

Miratohet ndihma ekonomike me nr.11 , për periudhën 1- 31 janar nga 6%.

Të ndryshme

Kryetari Këshillit lexon kërkesat, ankesat...

Kërkesë e shoqatës “ Bregdeti” Për emërtim rruge .

Kryetari këshillit:- ne nuk kemi komision për këtë çështje, kryesia e fshatit duhet të sjellë këtë kërkesë.

Milto Nika :- të konsultohemi me juristë.

Materiali i kalin zyrës juridike për procedurë.

Shqyrtohet kërkesa e bashkëfshatarëve të Qeparoit për emërtim rruge kryesore “ Margarit Gjoka’ e kërkon si miratim. Kjo nuk është kompetencë e zotërisë :- thekson këshilli.

Kërkesa e z.Vero Lalaj :- kërkon tokë me qera , i kalon drejtorisë përkatëse për shqyrtim.

Kërkesë nga Vizion Qelbërt kërkon mbështetje nga bashkia për krijimin e një grupi vendor dhe kulturor , i kalin zyrës juridike .

Lexohet një urdhër nga bashkia si informacion për këshillin për ngritje e një këshilli vendor për sigurinë publike.

Shqyrtohet një relacion që ka kërkuar Këshilltari Timoleo Gërdhuqi, e lëmë për në mbledhjen e radhës .

Znj.Afrovita Dhimojani:- Kryetarët e fshatrave duhet të vijnë në çdo mbledhje të Këshillit sepse dalin probleme dhe duam ti diskutojmë me ta , nëse nuk paraqiten në mbledhjet në vazhdim do të marrim masa të tjera për ta.

Z. Timoleo Gërdhuqi:- Kemi kryetar fshatrash që kanë shkelur ligjin , ne kemi të drejt të çojmë një komision dhe të ndjekim detyrën e tyre në bazë të ligjit .

Kryetari Këshillit :- Kryetarët e fshatrave kanë shkelur detyrën dhe do të marrim masa për fshatin Gjilekë, Kuç , Pilur.

Këshilli propozojë të ngrejë komision me anëtarët e këshillit :-

1. Timoleo Gërdhuqi , 2 . Afrovi Dhimojani , 3. Mirka Gjçali, 4. Qirjako Mërkuri , 5 . Dhimitër Kapaj

Në mbledhjen e radhës ky komision të miratohet me vendim.

Mbyll mbledhjen kryetari këshillit.

Sekretari

Elena Memushaj

